



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 145 prot.

Kamëz, më 5.11.2024

V E N D I M

Nr. 107 Datë 5/11/2024

M B I

“RISHIKIMIN E PLANIT TË PËRGJITHSHËM VENDOR ME PROCEDURË TË
THJESHTUAR, BASHKIA KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 05.11.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.82 Datë 04.11.2024 në mbështetje të pikës 1, germa "a" dhe pika 2 të nenit 113 të Kushtetutës; Nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronjat "a" dhe "b", nenit 29, pikat 3 dhe 4, nenit 33, pika 1, nenit 54, shkronja "k" dhe nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; i ndryshuar; Ligjit nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar; Vkm-së nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", e ndryshuar, udhëzimin e AKPT-së nr. 1, datë 06.12.2021 "Për hartimin bashkërendimin miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të PPV-ve me procedurë të thjeshtuar"; Udhëzimin nr. 47, datë 11.05.2022 "Për një shtesë në udhëzimin e AKPT-së nr. 1, datë 06.12.2021 "Për hartimin bashkërendimin miratimin dhe kontrollin e procesit të rishikimit të dokumentave të PPV-ve me procedurë të thjeshtuar"; Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 01, datë 27.07.2022 "Për miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Kamëz", Vendimin nr 157 datë 13.02.2024 të Kryetarit të Bashkisë, **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e dokumentit të rishikuar sipas nismës për “Rishikimin e dokumentit të planit të përgjithshëm vendor Bashkia Kamëz”, me procedurë të thjeshtuar sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Drejtorja e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit për ndjekjen e procedurave ligjore.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.



KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI